



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

## KËRKESAT E KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Niazi JAHO  
*Konstitucionalist*

KShH që nga themelimi i tij (1990) dhe në vazhdim është angazhuar në fushën e mbrojtjes së lirisë dhe të drejtave të shtetasve. Në këtë kuadër, ai i është drejtuar disa herë dhe Gjykatës Kushtetuese për deklarimin antikushtetues të ligjeve, apo dispozitave përkatëse ligjore, që mendohej se binin ndesh me dispozitat kushtetuese dhe Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Për përgatitjen e këtij materiali u jam referuar kryesisht vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të periudhës 1997 – 2011 dhe kam synuar t’u vijë sadopak në ndihmë të interesuarve. Ndërsa, ky material i natyrës arkivore për organizatat joqeveritare (OJF) mund të jetë nxitje që në raste të veçanta, në përputhje me nenin 134, pika 1, shkronja “f” dhe pikës 2 të Kushtetutës, t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese me kërkesa për shfuqizimin e dispozitave ligjore që bien ndesh me Kushtetutën.

Kërkesat e KShH-së para miratimit të Kushtetutës së vitit 1998

Siç dihet, në vitin 1992 u krijua Gjykata Kushtetuese. Sipas ligjit kushtetues të asaj kohe, organizatat joqeveritare nuk legjitimoheshin t’i drejtoheshin Gjykatës Kushtetuese me kërkesa për deklarimin anti-kushtetues të ligjit, apo dispozitave përkatëse ligjore. Me gjithë këtë, në ligjin e vitit të mësipërm thuhej, se Gjykata Kushtetuese kishte kompetencë të shqyrtonte çështje të tilla me nismën e vet. Duke shfrytëzuar këtë mundësi, KShH në vitin 1997 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për çështjet e mëposhtme:<sup>1</sup>

1. Në Shkurt të vitit 1997, KShH i kërkoi Gjykatës Kushtetuese që të shpallë si të papajtueshëm me Kushtetutën nenet 1, 2 dhe 26 (paragrafi 2), si edhe sanksionet e përcaktuara në nenet 5, 7-10, 12, 13 (paragrafi i parë) të ligjit nr.8175, datë 23/12/1996 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27/01/1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë””. Në këto dispozita caktoheshin dënime fikse. Kërkohej gjithashtu të deklarohet anti-kushtetues ligji nr.8981, datë 27/12/1996 “Për një ndryshim në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Procedurës Civile”, që i njihte prokurorit të përgjithshëm ushtrimin e rekursit në interes të ligjit, gjë që binte ndesh me ligjin kushtetues nr.7561, datë 29/04/1992. Në mënyrë të veçantë, KShH i kërkonte Gjykatës Kushtetuese për parandalimin e pasojave të dëmshme edhe pezullimin e dispozitave që përcaktonin dënime fikse.

Gjykata Kushtetuese, mbas marrjes së kërkesës së mësipërme, në vendimin e saj paraprak theksonte, se: *“Komiteti Shqiptar i Helsinkit nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për papajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, për arsye se ai nuk përfshihet në subjektet që kanë të drejtë të bëjnë kërkesë sipas nenit 25, paragrafi i dytë i ligjit kushtetues nr.7561, datë 29/04/1992, por duke çmuar rëndësinë e çështjeve të ngritura nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe duke parashikuar pasojat që mund të vijnë nga zbatimi i një pjese të normave penale të ndryshuara, gjykata çmon, në bazë të nenit 25 të ligjit të mësipërm kushtetues, t’i marrë ato në shqyrtim me nismën e saj.”*

<sup>1</sup> Shih: *Përmbledhje të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese 1992 – 1997*



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Ndërsa, në vendimin e saj përfundimtar, Gjykata Kushtetuese arsyetonte, se:

- a) Sanksionimi i dënimeve fikse bie ndesh me parimet e sanksionuara në nenet 47-50 të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal. Ato eliminojnë mbrojtjen për sa i përket shkallës së rrezikshmërisë së veprës së kryer dhe autorit të saj. Si rrjedhojë, ato çenojnë të drejtat themelore të njeriut, të garantuara në parimet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor dhe për një gjykim të drejtë (nenet 38 e 40 të ligjit kushtetues nr.7692, datë 31/03/1993 “Për të drejtat dde liritë themelore të njeriut”). Në përfundim, Gjykata Kushtetuese vendosi pezullimin e dispozitave të Kodit Penal që përmenden në kërkesën e KShH-së deri në rregullimin e tyre nga Kuvendi. Më vonë, siç dihet, Kuvendi, duke pasur parasysh vendimin e mësipërm bëri ndryshimet përkatëse.
- b) Gjykata Kushtetuese morri në shqyrtim edhe kërkesën e KShH-së për deklarimin antikushtetues të nenit 43 të ligjit nr.8175, datë 23/12/1996 “Për ndryshime në Kodin Penal” dhe ligjin nr.8180 e nr.8181, datë 23/12/1996, përkatësisht “Për një ndryshim në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Procedurës Civile”.

Në vendimin e saj thuhet, se të drejtën e rekursit nuk duhet ta ketë Prokurori i Përgjithshëm pasi kjo çënon barazinë e palëve. Prokurori i Përgjithshëm, sipas nenit 432/a të Kodit të Procedurës Penale, vihet në pozita të privilegjuara në krahasim me palën tjetër, e cila nuk e ka të drejtën që t’i drejtohet Kolegjit Penal me rekurs në interes të ligjit (për këtë, shih vendimin nr.55, datë 21/11/1997 të Gjykatës Kushtetuese).

2. Gjykata Kushtetuese, duke vlerësuar si të rëndësishme kërkesën e KShH-së për deklarimin antikushtetues të nenit 4 të ligjit nr.8195, datë 03/03/1997, ku bëhej fjalë për kufizimin në lirinë e shtypit dhe të informacionit, me datë 26/03/1997 e shqyrtoi atë me nismën e vet.

Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.14, datë 29/05/1997 nuk pranoi të drejtë kërkesën e KShH-së, me arsyetimin se neni 4 i ligjit të mësipërm është miratuar në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme (ligji nr.8194, datë 02/03/1997). Në këtë vendim thuhet sqë, megjithëse liria e shtypit dhe informacionit është një parim me vlerë konstitucionale, ajo mund të kufizohet në interes të mbrojtjes së interesit kombëtar dhe të integritetit tokësor.

Megjithëkëtë, në këtë vendim, domosdoshmëria e këtij kufizimi nuk argumentohet. Ndoshta kjo është edhe arsyeja që tre anëtarë të kësaj Gjykate ngelën në pakicë, por mendimi i pakicës nuk është publikuar.

3. KShH, në dhjetor të vitit 1997 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin si antikushtetues të nenit 43 të ligjit nr.8175, datë 23/12/1996, ku thuhej se për veprat e përmendura në këtë ligj, organet që bëjnë ndalimin e autorëve të veprave penale, brenda 48 orëve duhet t’i kërkonin prokurorit nxjerrjen e urdhërit për arrestimin e personave të ndaluar, i cili duhet të vendoste arrestimin ose ndalimin e tij.

Përmbajtja e kësaj dispozite binte ndesh me nenin 5 të ligjit kushtetues nr.7692, datë 31/03/1993, ku theksohej, se: “*Askush nuk mund të mbahej i ndaluar për më tepër se 48 orë*”. Kjo dispozitë ishte antikushtetuese, sepse ky hark kohor fillon nga çasti i ndalimit dhe mbërrin në çastin e vlerësimit të masës së sigurimit nga ana e gjykatës (shih për këtë nenet 257, 285, 259 (pika 5) të Kodit të Procedurës Penale).

Kërkesa e mësipërme e KShH-së ishte e bazuar dhe u pranua tërësisht nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

4. Në kërkesën e mësipërme të KShH-së përmendej edhe një shkelje tjetër e rëndësishme (në nenin 43 të ligjit të mësipërm) ku thuhet, se: “*Gjykata e Shkallës së Parë,*



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*pas kalimit të 5 ditëve nga nxjerrja e urdhërit të arrestimit, me kërkesën e urdhërit ose në bazë të ankimit të personit të arrestuar, vlerëson urdhërin e arrestimit”.*

Një shkelje tjetër gjithashtu e rëndë ishte edhe ajo që parashikohej në këtë dispozitë, se kundër vendimit të gjykatës për lirim të personit të arrestuar bëhet apel ose rekurs i drejtpërdrejtë nga ana e prokurorit, dhe në këto kushte, vendimi për lirim të menjehershëm të personit të arrestuar pezullohej deri në marrjen e vendimit nga gjykata që do të shqyrtonte çështjen.

Shkeljet e mësipërme, siç thuhet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.58, datë 05/12/1997 binin ndesh me nenin 5 të ligjit nr.7962, datë 31/03/1993 dhe nenin 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, dhe për këto arsye Gjykata Kushtetuese e shpalli antikushtetuese dispozitën e nenit 43 të ligjit nr.8175, datë 23/12/1996.

Kërkesat e KShH-së drejtuar Gjykatës Kushtetuese pas miratimit të Kushtetutës së 1998-ës dhe deri në fund të vitit 2011<sup>2</sup>

Sipas nenit 134 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese mund të vihet në lëvizje, veç subjekteve të tjera edhe nga organizatat, por vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Në mbështetje të këtij neni, KShH, duke filluar nga viti 2003 i është drejtuar disa herë Gjykatës Kushtetuese.

5. Në Janar të vitit 2003, KShH, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, shtronte çështjen e shqyrtimit të nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale. Objekti i kësaj kërkesë ishte shfuqizimi si antikushtetues i nenit 410/2 të ligjit nr.7905, datë 21/03/1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13/06/2002”. Në vendimin e Gjykatës fillimisht arsyetohet legjitimiteti i KShH-së në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës. Në të thuhet, se: “Komiteti Shqiptar i Helsinkit është një organizatë e njohur për veprimtarinë e saj në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, i cili sipas statutit ka si objekt dhe qëllim vëzhgimin e gjendjes lidhur me këto të drejta. Duke patur një qëllim të tillë, ai ka statusin e një kërkuar legjitim sipas nenit 134 të Kushtetutës”.

KShH në kërkesë ngriti edhe çështjen e shtesës që i ishte bërë nennit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale me fjalët: “i pandehuri”, sepse kjo shtesë binte ndesh me parimin kushtetues të mbrojtjes në procesin penal. Para këtij ndryshimi, në nenin 410, pika 2 e K.Pr.P, thuhej: “Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji”. Mirëpo, me përmirësimin që i është bërë këtij paragrafi, duke shtuar pas fjalës “lëshuar”, fjalën “i pandehur”, mbrojtësit i mohojë e drejta për të bërë ankim dhe për të marrë pjesë në gjykimin në shkallë më të lartë, nëse ai nuk do të ishte i pajisur me akt përfaqësimi të lëshuar nga i pandehuri. Cenimi i së drejtës së ankimit dhe të mbrojtjes ishte themelore dhe në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr.15, datë 17/04/2003 e konsideroi të bazuar kërkesën e KShH-së. Në këtë vendim, veç të tjerave thuhet, se interpretimi i ngushtë i nenit 410/2 të bërë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke kufizuar të drejtën e mbrojtjes për të bërë ankim ndaj vendimit të dhënë në mungesë të të gjykuarit, bie ndesh me parimet kushtetuese, nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën e Gjykatës së Strasburgut.

<sup>2</sup> Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2003, 2004, 2006, 2010 dhe 2011



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Me këtë shpjegim, siç theksohet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, nuk krijohet ndonjë boshllëk ligjor. Si rrjedhim, organi ligjvënës nuk është nevoja të bëjë ndonjë plotësim (shih vendime të Gjykatës Kushtetuese, viti 2003, fq 66-75).

6. Në 10 Qershor 2003, Gjykata Kushtetuese mori në shqyrtim kërkesën e KShH-së me objekt: “Shfuqizimin si antikushtetues të nenit 437, pika 3 dhe 5 të Kodit të Procedurës Penale si dhe të nenit 483, paragrafi i dytë dhe pjesërisht paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile”.

Në kërkesën e KShH-së shtrohej çështja që i pandehuri ose pala në procesin civil duhet të kenë të drejtë të mbrohen personalisht në Gjykatën e Lartë.

Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.25, datë 30/07/2003 nuk e konsideroi të bazuar kërkesën e KShH-së. Në vendim, veç të tjerave, thuhet që mbrojtja me avokat i shërben më mirë krijimit të sigurisë juridike dhe dhënies së drejtësisë në përgjithësi, se në seancën gjyqësore që zhvillohet në Gjykatën e Lartë nuk kemi cenim të parimit të përgjithshëm. Në vendimin e Gjykatës thuhet, gjithashtu, se sipas kodeve të Procedurës Penale dhe Civile, rekursi në Gjykatën e Lartë mund të bëhet vetëm: a) për mosrespektim apo zbatim të gabuar të ligjit; b) për shkelje të rënda të normave procedurale; c) për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Pra, në tre rastet bëhet fjalë për zbatim të gabuar ose shkelje të ligjit material ose procedural (shih vendime të Gjykatës Kushtetuese, viti 2008, faqe 127-135).

7. Gjykata Kushtetuese me dt. 14/06/2004, mori në shqyrtim kërkesën e KShH-së me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 34 të ligjit nr.9049, datë 10/04/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

Kundërshtojë përmbajtja e nenit 34 me titull “Publikimi” ku thuhej, se: *“Të dhënat që përfitohen nga deklarimi sipas këtij ligji janë të lejueshme për publikun në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30/06/1999 “Për të drejtën e informimit”.*

Veç kësaj, po në këtë kërkesë, në mënyrë të veçantë theksohej, se nuk duhet të publikoheshin të dhënat pasurore të personave, që sipas këtij ligji nuk ishin subjekte deklarimi.

KShH nuk shprehej kundër paraqitjes së të dhënave financiare, por kundër publikimit të tyre pa pëlqimin e subjekteve që parashikon ligji. Në këtë vështrim, KShH shprehej për zbatimin e dispozitës përkatëse të ligjit për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 35 i Kushtetutës dhe neni 8 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut).

Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën e KShH-së, me arsyetimin se e drejta e informimit, si element kryesor të saj kishte lirinë personale për të marrë dhe për të dhënë informacion, se media është një bazë e rëndësishme për të kontrolluar dhe gjykuar se si funksionarët e veshur me pushtet ushtrojnë autoritetet publik dhe se si i menaxhojnë fondet publike.

Qëllimi kryesor i këtij ligji - thuhet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese - është intensifikimi i luftës kundër korrupsionit. Megjithëse me këtë vendim rrëzohet kërkesa e KShH-së, qoftë edhe në mënyrë indirekte pranohej një nga çështjet që trajtoheshin në këtë kërkesë. Kështu, në këtë vendim thuhet, se personat që nuk janë subjekte që bartin detyrimin për deklarim (persona të tretë apo familjarë të tyre), edhe pse këto të dhëna mund t'i jepen publikut, *“nuk mund të jepen emrat konkrete të këtyre personave, aq më tepër që ata mund të mos jenë në dijeni për deklarimin e bërë në emrin e tyre si dhe për saktësinë e këtij deklarimi”.* (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.16, dt.11/11/2004, vëllimi i vitit 2004, faqe 112-137).



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

8. Në vitin 2006, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr.43, datë 27/01/2006 “Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimin e pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës publike”, vendimin nr.44, datë 27/01/2006 “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike” dhe vendimin nr.48, datë 27/01/2006 “Për disa shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13/04/1999 “Për miratimin e dispozitave të Kodit Doganor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”.

Meqë të tri vendimet e mësipërme cenojnë të drejtat themelore të njeriut të sanksionuara në Kushtetutën tonë dhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, KShH i kërkoi Gjykatës Kushtetuese t’i shpallte ato në kundërshtim me Kushtetutën. Por, paraprakisht, KShH kërkoi pezullimin e zbatimit të tyre, sepse pasojat mund të ishin të dëmshme. Si bazë ligjore përmendeshin nenet 17, 18, 49, 107, 116, 118, 131/2 dhe 134/dh të Kushtetutës.

Argumentat që parashtroheshin në kërkesën e KShH-së, në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

- a) Kufizimi i të drejtave themelore mund të bëhet vetëm me ligj dhe vetëm me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.
- b) Vendimet diskriminojnë punonjësit, krijojnë diferencime të kundraligjshme, gjë që bie ndesh me nenet 18 dhe 49 të Kushtetutës.
- c) Për kufizimin e të drejtave, interesi publik ose mbrojtja e të drejtave të të tjerëve vlerësohet nga Kuvendi dhe jo nga Këshilli i Ministrave.
- d) Këshilli i Ministrave nuk është i autorizuar të nxjerrë akte nënligjore për kufizimin e të drejtave të shtetasve për shkak të lidhjeve të tyre familjare, të gjinisë ose të krushqisë. Neni 9 i Kodit të Punës ndalon çdo lloj diskriminimi.
- e) Përmbajtja e vendimeve të Këshillit të Ministrave bie ndesh me nenin 107 të Kushtetutës për caktimin e nëpunësve në administratën publike dhe garancitë e qëndrimit në detyrë.
- f) Këshilli i Ministrave nuk kishte të drejtë që vendimeve t’u jepte fuqi prapavepruese, etj.

Gjykata Kushtetuese paraprakisht vendosi pezullimin e zbatimit të vendimeve të mësipërme. Mbas një arsytimi të argumentuar dhe të detajuar që bëhet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese u vendos shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën të tre vendimeve të mësipërme.

Midis të tjerave, në pjesën arsyetuese të vendimit thuhet: “*Parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Disa nga elementët e shtetit të së drejtës që kanë të bëjnë me objektin e këtij shqyrtimi kushtetues janë parimi i ndarjes së pushteteve, miratimi i ligjeve në përputhje me Kushtetutën, mbështetja e veprimtarisë së organeve ekzekutive vetëm në ligj, kontrolli i administratës publike, garantimi i të drejtave dhe lirive themelore dhe parimi i sigurisë juridike*” (shih vendimin nr.20, datë 11/07/2006, vëllimi i vitit 2006, faqe 176-187).

9. Në datën 22/12/2008, Kuvendi, miratoi ligjin nr.10034 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”. Ky ligj u miratua me shumicë të thjeshtë të deputetëve. Objekti i këtij ligji ishte përcaktimi i subjekteve dhe funksioneve të larta shtetërore, të cilat ishin të papajtueshme me veprimtarinë publike të zyrtarit, për shkak të qënies anëtar, drejtues apo bashkëpunëtor në strukturat politikbërëse dhe zbatuese të dhunës së diktaturës së proletariatit, apo të ish sigurimit të shtetit, për periudhën 29 nëntor 1944 deri në 8 dhjetor 1990, i rasteve të papajtueshmërisë, i procedurave të verifikimit të pasojave të këtyre procedurave.



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KShH mbasi e studioi me vëmendje këtë ligj vendosi t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për shpalljen e tij të papajtueshëm me Kushtetutën, duke paraqitur argumentat e mëposhtme:

- a) Neni 13, shkronja "c" dhe 14 pikat 2 dhe 3 të ligjit, ku parashikohet, ndër të tjera, se KQZ-ja nuk duhet t'i regjistrojë si kandidatë personat e interesuar në rast se nuk paraqesin dëshminë e verifikimit, cenojnë një nga të drejtat themelore të shtetasve, të drejtën për t'u zgjedhur, duke shkelur nenin 45 të Kushtetutës.
- b) Cenohet neni 18 i Kushtetutës, ku sanksionohet barazia para ligjit dhe ndalimi i diskriminimit, për arsye se ky ligj vendos kufizime që nuk reflektojnë elementët dhe kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës. Kufizimet procedurale nga ligji nuk janë të domosdoshme në shoqërinë demokratike në konsolidim dhe bien ndesh edhe me orientimet e KE-së.
- c) Ligji bie ndesh me ligjet që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e organeve të parashikuara në Kushtetutë dhe që janë miratuar me tri të pestat e të gjithë deputetëve (nenet 6 dhe 81 pika 2 të Kushtetutës). Ligji për pastërtinë e figurës vendos shkak të ri për ndërprerjen e mandatit të deputetit, të zgjedhurit në gjykatë dhe prokurori. Këta janë zgjedhur në bazë të Kushtetutës dhe të ligjeve të miratuara me tri të pestat. Në këtë mënyrë, ligji cenon garancitë e institucioneve kushtetuese.
- d) Ligji cenon të drejtat e të emëruarve në administratën publike sipas statusit të nëpunësit civil dhe të Kodit të Punës të miratuar me tri të pestat e deputetëve.
- e) Ligji nuk shmang nga verifikimi as subjektet që i janë nënshtruar verifikimit sipas ligjit të mëparshëm. Në këtë mënyrë, ligji cenon parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtën shkelje dhe për të njëjtat fakte.
- f) Formulimi i nenit 5 është arbitrar, sepse me një ligj të zakonshëm nuk mund të urdhërohet mosqënia pjesë e trupave gjyqësore që do të shqyrtojnë këtë ligj, apo çështje që lidhen me zbatimin e tij, të personave që ndodhen në kushtet e papajtueshmërisë së ligjit. Gjykatat në funksionin e tyre zbatojnë Kushtetutën, ligjin e tyre organik dhe Kodin e Procedurës Civile, që parashikojnë rastet e përjashtimit të gjyqtarëve.
- g) Neni 21 i ligjit bie ndesh me nenin 42, pika 2, të Kushtetutës ku sanksionohet parimi i procesit të rregullt ligjor.

KShH i kërkoi gjithashtu gjykatës që paraprakisht të vendoste pezullimin e ligjit për të parandaluar pasojat që mund të vinin nga zbatimi i tij dhe që mund të cenonin interesat shtetërore, shoqërore por edhe të individëve.

Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj u shpreh, se shkaqet për pezullimin e zbatimit të ligjit, në kuptim të nenit 45 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i vlerësoi të përligjuara për të argumentuar parandalimin e pasojave. Në arsyetimin e këtij vendimi pranohen si të bazuara të gjitha argumentet e parashikuara nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Në këtë vendim, veç të tjerave theksohet, se: *"Ligjvënësi, duke përfshirë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese në kategorinë e subjekteve që do t'i nënshtrohen verifikimit sipas nenit 3, gërma "d" të ligjit, duhet të konsideronte nevojën për të shmangur bllokimin institucional dhe për këtë duhet të kishte bërë rregullime të veçanta kushtetuese dhe ligjore...Kjo bie ndesh me nenin 124 të Kushtetutës. Ky qëndrim në parim, për analogji është shprehur edhe në vendime të mëparshme të gjykatës (vendimi nr.21, datë 01/10/2008 dhe nr.4, datë 02/06/1995). Në këto kushte, gjykimi lidhur me kërkesën për përjashtimin e disa gjyqtarëve duhet të mbështetet në vlerësimin e rëndësisë që ka*



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*paanshmëria e gjyqtarëve, por edhe në nevojën për kontrollin e ligjeve të Kuvendit nga Gjykata Kushtetuese”.*

Në pikën 89 të vendimit thuhet se *“Parimi i proporcionalitetit kërkon që periudha e përjashtimit të jetë e kufizuar dhe të marrë në konsideratë rrethanat individuale. Kohëzgjatja e përjashtimit nga një funksion publik duhet të varet nga njëra anë nga progresi në vendosjen e një shteti demokratik të së drejtës dhe nga ana tjetër nga mundësia për ndryshimin pozitiv në sjelljen dhe qëndrimin e subjektit të lustracionit.. Periudha kohore gjatë së cilës do të shtrihet kontrolli duhet të jetë e kufizuar, pasi aktivitetet e kryera në të kaluarën nuk përbëjnë një provë përfundimtare të sjelljes aktuale apo të sjelljes në të ardhmen e individit”.* Dhe, më poshtë, në pikën 90 të vendimit thuhet, se: *“Gjykata ka parasysh standartet e KE-së, të cilat rekomandojnë një kohë maksimale prej 5 vjetësh nga skualifikim...tejkalimi duhet të justifikohet në çdo rast konkret. Edhe në këto raste, Gjykata çmon se një përjashtim i papërcaktuar nga funksioni publik, pa patur mundësinë për ta fituar atë ngre problemin e proporcionalitetit”.*

Për arsyet e mësipërme, Gjykata me unanimitet vendosi shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit nr.10034, datë 12/12/2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve (shih vendimin nr.9, datë 23/03/2010, vëllimi i vitit 2010, faqe 138).

10. Në 03/12/2009, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një ligj të rëndësishëm “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

KShH e studioi atë me vëmendje, u konsultua madje edhe me specialistë të fushës kushtetuese dhe të procedurës penale e civile dhe arriti në përfundimin se ai në disa drejtime binte ndesh me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Për këtë arsye, më 10/02/2010, KShH ju drejtua Gjykatës Kushtetuese, duke parashtruar argumentat e mëposhtëme:

- a) Shprehja “dyshim i arsyeshëm bazuar në indicje”, parashikuar në nenin 3, paragrafi 1 i ligjit nuk është në përputhje me standartin “dyshim i arsyeshëm”, parashikuar në nenin 27/2, shkronja “c” të Kushtetutës, nenin 5/1 të KEDNJ-së dhe nenin 228/1 të Kodit të Procedurës Penale. Dyshimi i bazuar në indicje nuk mund të jetë “i arsyeshëm”.
- b) Ligji shkel të drejtën e pronës të sanksionuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit të KEDNJ-së. Ligjit i mungojnë garancitë ligjore për një proces të rregullt ligjor, duke cënuar kështu të drejtën e pronës, sepse në mënyrë të panevojshme legjitimon hetimin, gjykimin ose vendosjen e masave me karakter pasuror ndaj çdo biznesi ose qytetari. Ligji nuk parashikon kriteret ose kushtet ligjore që duhet të plotësojë kërkesën e prokurorit për konfiskimin e pasurive.
- c) Ligji shkel të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së). Ligji mohon të drejtën e aksesit efektiv në gjykata, sepse kërkesa për vendosjen e sekuestros shqyrtohet nga gjykata në praninë e prokurorit. Nenet 101, 13 dhe 23/1 të ligjit janë në kundërshtim me thelbin e procesit të rregullt ligjor.
- d) Ligji shkel parimin e prezumimit të pafajsisë, sepse neni 24/2 i ligjit parashikon që zbatimi i masave me karakter pasuror do të vazhdojë në rastet kur ndaj personit - subjekt i ligjit ka pushuar procedimi penal dhe ai është shpallur i pafajshëm, çka është ndryshim cilësimi ligjor i veprës.



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- e) Ky ligj është antikushtetues, sepse bie ndesh me parimin e hierarkisë së akteve ligjore të sanksionuara në Kushtetutë (nenet 8, 9, 11, 12, 16, 21, 23 dhe 38 të ligjit), sepse Prokurorisë i shtohen kompetenca të tjera që nuk parashikohen as në Kodin e Procedurës Penale dhe as në ligjin organik të Prokurorisë. Ligji shkel nenin 81 të Kushtetutës, sepse parashikon dispozita të veçanta për procedurën që duhet në këtë gjykim sui generis. Ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës për Krimet e Rënda është miratuar me 3/5 e të gjithë deputetëve, ndërsa ligji - objekt shqyrtimi është miratuar me votim të thjeshtë. Është cenuar pika 2 e nenit 135 të Kushtetutës ku thuhet se : *”Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata për fusha të veçanta”*.

Vlen të përmendet që, megjithëse subjekti i interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, gjatë shqyrtimit të çështjes pretenduan moslegjitimitimin e KShH-së, Gjykata u shpreh: *“Sipas statutit të saj, KShH-ja është një organizata jofitimprurëse që ka si mision mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky funksion lidhet edhe me kujdesin për përvojën e legjislacionit vendas të dispozitave që garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve. Gjykata vëren se kërkuesi ka parashtruar para gjykatës argumente se si dispozitat e ligjit, objekt i këtij kontrolli kushtetues, çënojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat kjo organizata ka për mision që t’i mbrojtë. Ndaj gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi legjitimohet si subjekt për të iniciuar kontrollin kushtetues të ligjit, objekt shqyrtimi lidhur me pretendimet për cënim të të drejtave për një proces të rregullt ligjor, të drejtën e pronës dhe të drejtën për mbrojtjen e jetës private”*.

Gjykata Kushtetuese në përfundim e rrëzoi kërkesën e KShH-së, veç të tjerave me arsyetimin se:

- Shprehja “indicje” nuk ndikon në cenimin e një procesi të rregullt ligjor.
- E drejta e pronës nuk cenohet, sepse kjo është një procedurë e posaçme që zbatohet për vepra të rënda kriminale.
- Gjykata vlerëson se nevojat parandaluese të parashikuara në ligj çënojnë të drejtën e pronës, por çështja që shikohet është nëse kufizimet janë të nevojshme, pra bëhen për një interes publik dhe janë në përpjestim me gjendjen që ka diktuar marrjen e këtyre masave (Neni 17/1 i Kushtetutës).
- Masa e konfiskimit merret nga Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda. Në këtë rast mbrojtja e pronës është objekt i shqyrtimit gjyqësor.
- Ky është një proces i veçantë autonom nga procesi penal, pra nuk cenohet parimi i prezumimit të pafajsisë.
- Kërkuesi nuk ka dhënë argumente bindëse lidhur me standartin “gjykatë e caktuar me ligj” (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.4, datë 23/02/2011).

Lidhur me shqyrtimin e kësaj çështjeje dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese, interes paraqet mendimi i shfaqur nga gjyqtari që ka mbetur në pakicë. Ai shprehet, se: *“cënimi i elementit të gjykatës së caktuar me ligj, i argumentuar në kërkesë, por edhe në seancën plenare, si një ndër pretendimet kryesore të kërkuesit, nuk rezulton të ketë marrë përgjigje nga gjykata në vendimin e saj. Formulimi i përdorur nga shumica, se kërkuesi nuk ka dhënë argumente bindëse, mendoj se nuk është koherent me atë që vetë gjykata ka shprehur në krye të vendimit të saj”*. Dhe, më poshtë: *“detyrë e gjykatës është t’i përgjigjej pretendimit të kërkuesit për standartin e gjykatës së caktuar me ligj”*. Gjyqtari në pakicë thekson gjithashtu, se: *“shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj është një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Një standart i tillë “mbulon jo vetëm ” bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të*





## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

*ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete” (shih vendimin nr.14, datë 17/04/2009 të Gjykatës Kushtetuese). Më poshtë: “Pretendimet e kërkuarit se Gjykatës për Krimet e Rënda i është ndryshuar përbërja e trupit gjykues, si dhe i është zgjeruar juridiksioni gjyqësor me një ligj të thjeshtë që kundërshton haptazi ligjin e saj organik, por edhe Kodin e Procedurës Penale, shumica i është përgjigjur nëpërmjet mosdhënies së përgjigjes”. Në përfundim, ai shprehet, se: “Shpallja si antikushtetues i ligjit objekt shqyrtimi është miratimi nga ligjvënësi i një ligji tjetër, në respekt të normave kushtetuese, do të ishte zgjidhja më e drejtë për të parandaluar dhe për të goditur krimin e organizuar dhe trafikimin, nëpërmjet marrjes së masave parandaluese kundër pasurisë”.*

11. Në shkurt të vitit 2011, KShH ju drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të ligjit nr.10308, datë, 22/07/2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29/07/2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës, i ndryshuar”. U kërkuar, gjithashtu, edhe pezullimi i zbatimit të ligjit deri në përfundimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

Kërkesa mbështetej në argumentet e mëposhtëme:

- a) Ky ligj cenon parimin e sigurisë juridike (neni 4 i Kushtetutës), pasi parashikon të drejtën e rishikimit të vendimeve të AKKP-së, të cilat ashtu si vendimet gjyqësore nëse nuk janë ankimuar brenda afateve ligjore marrin formë të prerë.
- b) Cenohet parimi i ndarjes së pushteteve (nenet 7 dhe 135 të Kushtetutës), pasi ligji autorizon AKKP-në të shqyrtojë, apo rishqyrtojë, çështje që mund të ishin objekt shqyrtimi vetëm nga gjykatat e sistemit të zakonshëm. Në kuptim të nenit 141/1 të Kushtetutës dhe dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, të drejtën e verifikimit të çështjeve në rrugë gjyqësore e ka vetëm Gjykata e Lartë.
- c) Kompetenca e drejtorit të AKKP-së për rishikimin e vendimeve përfundimtare të ish KKKP-ve, bie ndesh me të drejtën subjektive dhe, si rrjedhim, shqyrtimi i së drejtës së pronësisë, nuk mund të bëhet nga një organ administrativ që është në varësi të pushtetit ekzekutiv (Këshillit të Ministrave), por vetëm nga gjykatat e sistemit të zakonshëm. Ligji - objekt kundërshtimi përbën në vetvete një kufizim të së drejtës së pronës që cenon thelbin e së drejtës, pa patur interes publik dhe as në mbrojtje të të drejtave të të tjerëve, ose në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar (neni 17/2 i Kushtetutës).

Gjykata Kushtetuese paraprakisht vendosi pezullimin e ekzekutimit të ligjit, ndërsa me vendimin e saj nr.43, datë 06/10/2011, mbas një analize të hollësishme dhe të argumentuar vendosi shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të neneve 2, 3 dhe 5 të ligjit nr.10308, datë 22/07/2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29/07/2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës, i ndryshuar”. Nga kjo del, se kërkesa e KShH-së lidhur me këtë çështje u pranua në tërësi nga Gjykata Kushtetuese.